



Financuar nga Bashkimi Evropian



Zbatuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese

STUDIM

ANALIZË E LEGJISLACIONIT DHE INICIATIVAVE MBI EKONOMINË QARKULLUESE NË SHQIPËRI

Shkurt 2020

NË KUADËR TË PROJEKTIT

“RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT TË OJQ-VE DHE NVM-VE MBI RËNDËSINË E EKONOMISË QARKULLUESE NË LINJË ME
PAKETËN E BE-SË PËR EKONOMINË QARKULLUESE”

Financuar nga Bashkimi Evropian

Zbatuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese

Tabela e Përmbajtjes

Lista e akronimeve.....	2
Parathënie	3
Hyrje	3
Origjina e Ekonomisë Qarkulluese	5
Ekonomia Qarkulluese në Shqipëri	6
Analizë e iniciativave ekzistuese apo të planifikuara mbi rritjen e ndërgjegjësimit mbi EQ në Shqipëri	9
1. Sektori privat (NVM-të)	11
1.1. Prodhimi dhe konsumi në Shqipëri.....	12
2. Organizatat jo-qeveritare (OJQ).....	13
3. Akademia.....	13
Konkluzione	14
Referencat	15

Lista e akronimeve

BE	Bashkimi European
BP	Ballkani Perëndimor
CCS	Centre for Competitive Skills (Qendra për Aftësi Konkurruese) EQ Ekonomia Qarkulluese
GIZ	Agjencia gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar IPA Instrumenti i para-aderimit
KE	Komisioni European
KFW	Banka gjermane e Zhvillimit LLRM Llogaritë e rrjedhës së materialit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
OJQ	Organizatë jo qeveritare
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim
SLLK	Sistemi i Llogarive Kombëtare
	UNECE Komisioni Ekonomik për Europën e Kombeve të Bashkuara

Parathënie

Ekonomia Qarkulluese (EQ) është kthyer në një temë shumë të rëndësishme mes politikbërësve të Bashkimit Evropian. EQ mbart në vetvete konceptet e inovacionit, qëndrueshmërisë dhe eficiencës së burimeve, me qëllimin final të një rritje ekonomike të gjelbër.

Ky studim është kryer në kuadër të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit të OJQ-ve dhe NVM-ve mbi rëndësinë e Ekonomisë Qarkulluese në linjë me Paketën e BE-së për Ekonominë Qarkulluese”, financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet instrumentit IPA 2015 dhe i zbatuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese (CCS).

Studimi jep një panoramë të legjislacionit shqiptar lidhur me Ekonominë Qarkulluese dhe iniciativat e ndërmarra për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj Ekonomisë Qarkulluese. Metodologjia e përdorur përbëhet nga kërkimi (*desk research*) dhe intervistat me aktorët relevantë (qeverisja qendrore dhe vendore, akademia, sektori privat dhe shkollat).

Ky dokument është mundësuar nga mbështetja financiare e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Aftësi Konkurruese (Center for Competitive Skills), dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

Hyrje

Bashkimi Evropian synon ta kthejë Europën në kontinentin e parë në botë që është neutral ndaj ndryshimeve klimatike (*climate-neutral*) brenda vitit 2050. Por arritja e këtij objektiv është shumë sfiduese dhe kërkon angazhim me strategji dhe plane konkrete aksioni.

Kështu, BE miratoi në dhjetor 2015, paketën e Ekonomisë Qarkulluese, e njohur si “Të mbyllësh lakun – Plan aksioni i BE-së për Ekonominë Qarkulluese”¹. Ndërsa në vitin 2018, BE miratoi “Strategjinë Europiane për plastikën në një Ekonomi Qarkulluese”².

¹ “Closing the loop - An EU action plan for the Circular Economy”

² “European Strategy for Plastics in a Circular Economy”

Më 11 dhjetor 2019, Komisioni European prezantoi Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së³, që është një paketë me masa ambicioze që synojnë krijimin e një ekonomie europiane të qëndrueshme. Kjo paketë ka si qëllim që ti kthejë sfidat mjedisore në mundësi ekonomike për qytetarët dhe bizneset. Paketa përbëhet nga një udhërrëfyes me masa, të cilat në mënyrë direkt dhe indirekte, kontribuojnë në arritjen e objektivave të BE-së për kalimin në një Ekonomi Qarkulluese. Gjithashtu, Bashkimi European parashikon të mbështesë edhe vendet fqinje në Ballkanin Perëndimor dhe në Afrikë në përpjekjet për kalimin drejt një ekonomike qarkulluese, nëpërmjet partneriteteve dhe programeve specifike.

Me prezantimin e Marrëveshjes së Gjelbër, Komisioni European u zotua që të hartojë një plan aksioni të ri për Ekonominë Qarkulluese. Ky zotim u arrit në Mars të vitit 2020, kur KE miratoi dhe prezantoi PlanAksionin e ri.

Një nga përkufizimet më të cituara për EQ, që përfshijnë elemente nga disiplina të ndryshme, është ai i fondacionit Ellen MacArthur (2013a, fq. 7), i cili e përshkruan ekonominë qarkulluese si “një sistem industrial që është restaurues ose rigjenerues për nga qëllimi dhe struktura. Ai zëvendëson konceptin ‘fundi i jetës’ me restaurimin, zhvendosjen drejt përdorimit të energjisë së rinovueshme, eliminon përdorimin e kimikateve toksike, të cilat dëmtojnë ripërdorimin, dhe synon eliminimin e mbetjeve përmes modelit superior të materialeve, produkteve, sistemeve, dhe po brenda kësaj, modelet e biznesit.”

Ky interpretim i konceptit përfshin dallimin e dy llojeve të ndryshme të materialeve⁴:

1. Materiale me origjinë biologjike që mund të rikthehen në biosferë si pleh (p.sh. produkte pyjore); dhe
2. Materiale teknike, që nuk biodegradojnë dhe nuk futen në biosferë (p.sh. plastikë dhe metale).

Kështu që ekonomia qarkulluese synon të mbajë të dy llojet e këtyre materialeve në përdorim në çdo kohë, përmes një modelimi, menaxhimi dhe inovacioni teknologjik të kujdesshëm (Fondacioni Ellen MacArthur, 2013a; 2015a).

³ https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en

⁴ Vlen të përmendet që sipas Vanner et al. (2014), ka raste si psh. Plastika e biodegradueshme, në të cilat nuk është e lehtë të bëhet ndarja.

Qëllimi i përgjithshëm është të "mundësojë flukse efektive të materialeve, energjisë, punës dhe informacionit në mënyrë që kapitali natyror dhe social të rindërtohen" (Fondacioni Ellen MacArthur, 2013b, f. 26).

Në nivel europian, Komisioni Europian (2015a, p. 2) e ka paraqitur konceptin e Ekonomisë Qarkulluese në Komunikatën e tij "*Closing the loop – An EU Action Plan for the circular economy*"⁵, që është pjesë përbërëse e Paketës së EQ⁶. Kështu, në këtë Komunikatë, EQ përshkruhet si një ekonomi "ku vlera e produkteve, materialeve dhe burimeve mbahet në ekonomi sa më gjatë që të jetë e mundur, ndërsa minimizohet gjenerimi i mbetjeve". Tranzicioni drejt një ekonomie qarkulluese do të sillte "një kontribut thelbësor në përpjekjet e BE-së për të zhvilluar një ekonomi të qëndrueshme, konkurruese, eficiente dhe me karbon të ulët". Në këtë kontekst, Plani i Veprimit i BE-së përfshin një seri masash që synojnë adresimin e ciklit të plotë të produktit nga prodhimi dhe konsumi deri te menaxhimi i mbetjeve dhe tregu i lëndëve të para dytësore.

Origjina e Ekonomisë Qarkulluese

Termi ekonomi qarkulluese është përdorur zyrtarisht në një model ekonomik për herë të parë nga Pearce & Turner (1990). Duke u mbështetur në parimin se "gjithçka është një burim për gjithçka tjetër", autorët hodhën një vështrim kritik në sistemin tradicional ekonomik linear dhe hartuan një model të ri ekonomik, të quajtur ekonomia qarkulluese, i cila zbaton parimet e termodinamikës.⁷

⁵ <https://ec.europa.eu/environment/circular-economy/>

⁶ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_15_6204

Marrëdhënia midis ekonomisë dhe mjedisit është e spikatur në këtë model, i cili përfshin tre funksione ekonomike të mjedisit: furnizuesi i burimeve, asimilatori i mbetjeve dhe burimi i shërbimeve⁸. Puna dhe linja e tyre e mendimit u frymëzuan nga puna e Kenneth Boulding dhe të tjerëve që diskutuan disa dekada më parë mbi kufijtë biofizikë të sistemit aktual ekonomik të ndërtuar mbi mbi-konsum dhe mbi një deficit ekologjik në rritje. Boulding (1966) prezantoi konceptin e sistemeve të mbyllura dhe parashikoi një ekonomi të ardhshme që do të funksiononte duke riprodhuar stokun e kufizuar të inputeve dhe riciklimin e rezultateve të mbetjeve. Një ekonomi e tillë "e mbyllur" do të kërkonte të ruajë totalin e stokut të kapitalit⁹ dhe do të qëndronte në kontrast të ashpër me ekonominë industriale të "mbështetur" nga e kaluara.¹⁰

Ekonomia Qarkulluese në Shqipëri

Në Shqipëri, për momentin nuk ka asnjë strategji të dedikuar për Ekonominë Qarkulluese. Megjithatë, në kuadrin ligjor që lidhet me mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri, mund të vërehen elementë që kontribuojnë në EQ, siç janë:

- Ligji Nr. 1043/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, i cili siguron parimet themelore të rritjes së gjelbër;

Ligjet Nr. 10436/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", Nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", dhe Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i cili gjithashtu siguron një mjedis bazë për instrumente të mundshme të ekonomisë qarkulluese.

⁷ Ligji i parë i termodinamikës përcakton që as energjia dhe as materia nuk mund të krijohen ose shkatërrohen, dhe për këtë arsye çdo burim natyror i përdorur do të kthehet në mjedis në formën e mbetjeve të ngurta ose të shkarkimeve. Sipas ligjit të dytë të termodinamikës, ekzistojnë kufij fizikë që parandalojnë vendosjen e një sistemi në të cilin të gjitha mbetjet riciklohen dhe shndërrohen përsëri në burime natyrore me efikasitet 100% (Pearce & Turner, 1990; Čiegis & Čiegis, 2008).

⁸ Në këtë model burimet janë një kontribut në procesin e prodhimit, i cili nga ana tjetër siguron mallra për konsum. Konsumi i mallrave krijon më pas shërbime ose mirëqenie. Mbetjet prodhohen në të tre fazat: përpunimin e burimeve, prodhimin (në formën e emetimeve dhe mbetjeve të ngurta) dhe mallrave të konsumit (Pearce & Turner, 1990).

⁹ Veçanërisht, konceptimi i Boulding (1966) për kapitalin përfshinte gjithashtu kapitalin njerëzor dhe njohuritë, përveç "tërësisë së të gjitha objekteve".

¹⁰ Boulding (1966) përdori termat "ekonomi hapësinore" dhe "ekonomi kauboj" për të kundërshtuar ekonomi të ndryshme: ekonomia e mbyllur e së ardhmes (ekonomia hapësinore) dhe ekonomia e hapur e së kaluarës (ekonomia cowboy).

Strategjia kryesore ndër-sektoriale e Shqipërisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 nënvizon rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të qeverisë qendrore dhe lokale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe gjithashtu jep disa parime të Ekonomisë Qarkulluese, siç janë masat për zhvillimin e industrisë së riciklimit, si dhe promovon pakësimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta komunale. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030 promovon mbrojtjen e mjedisit përmes përdorimit efikas të energjisë dhe diversifikimit të burimeve të energjisë.

Përpjekje të mëtejshme dhe më të fundit, që synojnë të kontribuojnë në kalimin drejt Ekonomisë Qarkulluese, mund të shihen në draftin e Dokumentit të politikave strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020 - 2035. Ky projekt-dokument nënvizon domosdoshmërinë e një kalimi gradual nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkulluese dhe prezanton disa aspekte të EQ, si parandalimi i mbetjeve, prokurimi i gjelbër dhe përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit (PZP).

Ka dy mënyra për të kaluar drejt një Ekonomie Qarkulluese:

- Parandalimi i mbetjeve dhe
- Përqafimi i sistemit "Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit" (PZP).

Shqipërisë i mungon një sistem PZP, megjithëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ka përfshirë konceptin në draftin e Dokumentit të politikave strategjike dhe planit kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035.

Për të mundur një zbatim të strategjisë së EQ në BE, elementët e Ekonomisë Qarkulluese futen në direktiva të ndryshme. Legjislacioni i BE për mbetjet është shumë i detajuar. Sidoqoftë, kuadri ligjor për trajtimin e mbetjeve në BE është vendosur në Direktivën Kuadër të Mbetjeve, e cila synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Kështu, kjo Direktivë nënvizon rëndësinë e menaxhimit dhe riciklimit të mbetjeve dhe përcakton detyrimin për të hartuar një plan për EQ.

Kjo Direktivë prezanton koncepte të rëndësishme si më poshtë:

- Paraqet parimin e "ndotësi paguan" me anë të të cilit prodhuesi fillestar i mbetjeve duhet të paguajë kostot e menaxhimit të mbetjeve.
- Prezanton konceptin e 'përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP)', i cili detyron prodhuesit të pranojnë dhe asgjësojnë produktet e kthyer pas përdorimit.

- Prezanton konceptin e statusit të mbetjeve dhe bën dallimin midis mbetjeve dhe nënprodukteve.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ajo prezanton objektiva riciklimi dhe rikuperimi që do të arrihen deri në vitin 2020 për mbetjet shtëpiake (50%) dhe mbetjet e ndërtimit dhe prishjes (70%).

Për më tepër, një numër i Direktivave të lidhura me mbetjet janë rishikuar, duke vendosur objektiva më ambicioze për riciklimin deri në vitin 2035 dhe duke zvogëluar sasinë e mbetjeve të depozituara në *landfille*.

Nisur nga sa më sipër, Shqipëria do të duhet të vazhdojë të përfshijë elementet për kalimin drejt EQ në legjislacionin e saj kombëtar. Kjo do të ndodhë përmes përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së. Përveç këtyre elementeve, do të duhet të prezantojë legjislacionin sekondar dhe kornizat operative për zbatimin e duhur të elementeve të EQ. Sipas raporteve të Progresit të BE-së dhe studimeve të ndryshme, Shqipëria aktualisht ka një nivel mesatar të përafrimit të *acquis* të BE-së për fushën e mjedisit, ndërsa puna në këtë drejtim vazhdon.

Sipas Raportit të BE-së për Shqipërinë (2018), kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së dhe instrumentet për të promovuar riciklimin dhe parandalimin e krijimit të mbetjeve, mbeten të ulëta. Direktiva kuadër e mbetjeve ka një nivel të ulët përafrimi në Shqipëri dhe për këtë arsye, ajo është gjithashtu në një fazë fillestare të zbatimit. Ndërsa, sipas Raportit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2019, në lidhje me nënsektorin e mbetjeve, nga Shqipëria kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur riciklimin dhe ripërdorimin, si dhe për të filluar kompostimin e mbetjeve bio. Ky raport gjithashtu pranon se ka instrumente të kufizuara ekonomike për të promovuar riciklimin dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve.

Paketa e Ekonomisë Qarkulluese e BE-së mbështet zbatimin e fushave të tjera të rëndësishme, siç është Paketa e Klimës 2020. Në këto aspekte, Shqipëria ka treguar njëfarë niveli përgatitjeje, edhe pse përafrimi është ende i kufizuar (Raporti i BE-së për Shqipërinë, 2018). Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike në korrik 2019.

Analizë e iniciativave ekzistuese apo të planifikuara mbi rritjen e ndërgjegjësimit mbi EQ në Shqipëri

Menaxhimi i mbetjeve është shumë i rëndësishëm për çdo vend pasi mbron si shëndetin e njeriut, ashtu edhe mjedisin. Rritja e ndërgjegjësimit për menaxhimin e mbetjeve për të mbrojtur mjedisin ka filluar në BE që në vitet 1980, duke çuar në legjislacionin e sotëm të detajuar, veprimet konkrete dhe gjithashtu financimin për Shtetet Anëtare dhe vendet candidate.

Në fakt, duke njohur rëndësinë e kalimit në Ekonominë Qarkulluese, BE ka planifikuar të sigurojë mbështetje për EQ dhe Rritjen e Gjelbër në Shqipëri përmes fondeve IPA për vitin 2019. Procesi i programimit të IPA 2019 në Ekonominë Qarkulluese ka qenë një fillim shumë i mirë që ka ndërgjegjësuar ministritë përkatëse të linjës - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - që kanë qenë pjesë e procesit të programimit, së bashku me Delegacionin e BE-së në Shqipëri. Rritja e ndërgjegjësimit në nivelin e hartimit të politikave është mjaft e rëndësishme për reformat dhe iniciativat e mëtejshme në përqafimin e ekonomisë qarkulluese. Ndërsa procesi i programimit të IPA 2019 është në vazhdim, veprimet kryesore që zakonisht parashikojnë këto paketa janë: ndërtimi i kapaciteteve, si në nivelin e hartimit të politikave ashtu edhe në nivelin e aktorëve të interesit, përmirësimi i kuadrit rregullator dhe mbështetja e aktorëve të interesit me praktikën më të mira të BE-së.

Mbështetja në fushën e EQ jepet edhe nga organizata gjermane GIZ, përmes projektit të quajtur "Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta në mënyrë miqësore me klimën dhe ekonomia qarkulluese në Shqipëri", i cili pritet të zgjatet përtej vitit 2019 dhe të ketë më shumë përqëndrim në ekonominë qarkulluese. GIZ tashmë ka ofruar projekte me fokus në "menaxhimin e mbetjeve"; dhe një program i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Korçë u financua nga KFW. Projekti i financuar nga KFW ka mbështetur 6 komuna përmes ngritjes së kapaciteteve dhe investimeve, siç është një deponi moderne në Maliq.

Mbështetja në formën e asistencës teknike për transpozimin e legjislacionit dhe të kuptuarit e procesit të negociatave të BE-së në fushën e mjedisit jepet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) përmes projektit "Mbështetja e negociatave shqiptare në mjedis - Kapitulli 27"¹¹.

Kjo jep një përmbledhje të mbështetjes së donatorëve të dhënë në fushën e Ekonomisë

Qarkulluese në Shqipëri. Iniciativat e tjera mund të shihen në një shkallë më të vogël të ndërmarrë nga kompani private, akademia ose OJQ-të.

Sipas website të YEE¹², projekti "Nxjerrja e Ekonomisë Qarkulluese nga hija - një qasje për një shoqëri aktive"¹³ zbatohet nga Qendra EDEN dhe Instituti Co-Plan për Zhvillimin e Habitatit për 10 muaj. Ky projekt vjen në kuadër të projektit En.Net, i mbështetur financiarisht nga BE dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin për EQ të rinjtë.

Kalimi në një ekonomi qarkulluese do të thotë risi; dhe inovacioni kërkon investime në teknologji dhe infrastrukturë. Inovacioni kërkon gjithashtu aftësi dhe edukim në fazat e hershme mbi rëndësinë e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ky projekt nënvizon rëndësinë e ndërgjegjësimit për EQ në tre segmente kryesore: NVM, OJQ dhe shkolla / universitete. Bazuar në këtë, studimi shikon nismat e kaluara, ekzistuese ose të planifikuara, në të tre këto segmente.

¹¹ <http://gencmyftiu.com/sane27/4594422241>

¹² <https://yeenet.eu/circular-economy-in-albania-just-a-glimpse/>

¹³ "Bringing Circular Economy out of shade – a brand attitude for active society"

1. Sektori privat (NVM-të)

Sipas Raportit të “Rishikimit të Performancës Mjedisore”¹⁴ të UNECE për vitin 2016, bizneset ende nuk janë ndërgjegjësuar për sistemet dhe standardet e menaxhimit të mjedisit, dhe as nuk ka stimuj për këtë. Nuk ka skema çertifikimi dhe iniciativa etiketimi. Gjithashtu, konsumatorët shqiptarë duket se janë joelastikë ndaj kërkesës për produkte dhe shërbime të gjelbërta.

Sipas raportit të UNECE, ekzistojnë disa nisma vullnetare nga sektori privat, kryesisht nga kompani që ndërmarrin aktivitete të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR) ose që miratojnë skema eko-çertifikimi. Për shembull, Shoqata Shqiptare e Bankave, e cila vazhdimisht organizon aktivitete CSR, ka kontribuar indirekt në elemente të lidhura me EQ duke miratuar mekanizma vetë-rregullues që promovojnë një mënyrë të përgjegjshme për të bërë biznes dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Mendohet se rreth 80 ndërmarrje private në Shqipëri janë angazhuar në riciklimin, grumbullimin dhe përpunimin e llojeve të ndryshme të mbetjeve, skrapit, letrës, plastikës, tekstileve dhe gomave të përdorura.

Kompania EVEREST IE, renditet si kompani inovatore në sektorin e plastikës dhe më e avancuar përse i përket EQ, duke sjellë në treg produkte nga lëndë të para të ricikluara.

Po ashtu kompania Edipack shpk e fokusuar në riciklimin dhe prodhimin e letrës dhe ambalazheve të kartonit.

Sipas Indeksit të fundit të Politikave të NVM-ve të OECD-së (2019), Shqipëria shënon 1.98 në dimensionin e "NVM-ve në një ekonomi të gjelbër" (krahasuar me 2.61 - rezultati mesatar i Ballkanit Perëndimor dhe rajonit të Turqisë - duke e bërë atë një nga pikët më të ulëta në rajon). Dimensioi mat kornizën për politikat mjedisore që synojnë NVM-të dhe stimujt / instrumentet për gjelbërimin e NVM-ve. Ky rezultat vlerëson pozitivisht ekzistencën e një strategjie në Shqipëri që targeton politikat mjedisore për NVM-të, me një fokus në eko-inovacion dhe prodhim më të pastër.

¹⁴ UNECE Environmental Performance Review of 2016

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 - 2020, e miratuar dhe zbatuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë, thekson masat për të rritur ndërgjegjësimin për zhvillimin e eko-produkteve dhe shërbimeve, eko-etiketimin, eko-çertifikimin dhe riciklimin. Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë për iniciativa dhe aktivitete konkrete të ndërmarra në këtë drejtim.

Sipas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ekzistojnë rreth 38 kompani private riciklimi në Shqipëri. Sipas Co-plan dhe Env.Net (2018), kompania "Green Recycling" përbën një nga rastet e suksesshme në Shqipëri, e cila kontribuon në një Ekonomi Qarkulluese përmes veprimtarive të saj të mbledhjes dhe riciklimit. Megjithatë, nivelet e riciklimit mbeten të ulëta në Shqipëri.

Sipas të njëjtit raport të Co-plan dhe Env.Net (2018), nisma të tjera të rëndësishme të sektorit privat që kontribuojnë në një Ekonomi Qarkulluese janë:

- "*Design by Pana*", një kompani sociale që prodhon produktet e saj përmes drurit të ripërdorur;
- "Shtëpia e Ofertave", e cila shet produkte të përdorura;
- Partneritetet publike-private midis Bashkisë së Tiranës dhe ndërmarrjeve private, të tilla si Mobike (përdorimi i biçikletave me qira për të promovuar mbrojtjen e mjedisit) dhe "Le ta kthejmë botën me solidaritet" (vendosja e shportave në disa pika të ndryshme, për të mbledhur rrobat e përdorura etj. dhe për të ndihmuar grupet vulnerabël).

1.1. Prodhimi dhe konsumi në Shqipëri

Sipas Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT), në vitin 2016, materialet e nxjerra nga burimet natyrore vendase që përfaqësojnë sasinë e përgjithshme të materialeve të përdorura drejtpërdrejt në ekonomi, arritën në rreth 28 milion ton, me një rritje prej 7.97% krahasuar me 2015.

Sipas strukturës, në vitin 2016, mineralet jometalë përbëjnë 63,48% të totalit, ndjekur nga biomasa me 28.56%, xehet metalike me 4.15% dhe materialet e energjisë fosile dhe transportuesit me 3.81%.

Sipas metodologjisë së përdorur nga INSTAT, Llogaritë e rrjedhës së materialit janë një nga modulet e Llogarive Mjedisore i cili mbledh të dhëna plotësuese për mjedisin në përputhje me konceptin e përdorur për përpilimin e Sistemit të Llogarive Kombëtare (SLLK).

Llogaritë e rrjedhës së materialit (LLRM) kanë si objektiv kryesor përshkrimin e marrëdhënieve midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror të saj. LLRM përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, qoftë drejtpërdrejtë në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt duke shkëputur materialet që do të përdoren për prodhim.

2. Organizatat jo-qeveritare (OJQ)

Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri nuk duket shumë i ndërgjegjësuar me konceptin e Ekonomisë Qarkulluese, ndaj kontributi i këtij sektori në EQ, aktualisht është shumë i vogël.

Gjatë viteve të fundit, ka patur disa projekte të vogla e sporadike, kryesisht projekte rajonale, gjatë viteve të fundit, ku OJQ-të shqiptare kanë qenë partnere në zbatimin e projekteve të fokusuara në Ekonominë Qarkulluese në Shqipëri. Vlen të përmenden projektet si më poshtë:

Projekti rajonal 3-vjecar “*ENV.net factoring the environmental portfolio for Western Balkans (WB) and Turkey in the EU Policy Agenda*” që ka filluar në Dhjetor 2017, i financur nga KE, është një bashkëpunim mes shtatë organizatave partnere nga Ballkani Perëndimor dhe dy partnerë nga Vendet Anëtare të BE.

Objektivat e Env.Net: ky projekt synon të përmirësojë dhe influencojë politikbërjen në fushën e ndryshimeve klimatike dhe legjisllacionit mjedisor në secilin nga vendet partnere të Env.Net. Env.Net shërben si një rrjet që do të gjenerojë input për të kontribuar në diskutimet e BE-së në çështjet e ndryshimeve klimatike dhe mjedisit, dhe të eksplorojë e të prezantojë në rajon aspektet e EQ. Në këtë process, ky rrjet parashikon të mbështesë gjithashtu OJQ-të dhe median, në aspektin teknik e financiar, në secilin nga vendet partnere, me qëllim kuptimin më mirë të këtyre çështjeve.¹⁵

Qendra EDEN¹⁶ zhvilloi një seminar për Ekonominë Qarkulluese si pjesë e këtij projekti - si një qasje e re për shoqërinë – mbështetur nga Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitave), si pjesë e projektit ENV.

3. Akademia

Në fushën e akademisë ka akoma më pak shembuj lidhur me angazhimin me EQ. Pavarësisht faktit që në fakultete si ai i Bioteknologjisë në Universitetin Bujqësor, dhe në degën të Bioteknologji Mjedisore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës trajtohen lëndë që janë në qendër të ekonomisë

qarkulluese, si psh. Teknologjia e trajtimit të mbetjeve, apo Energjia dhe Biomasa, ato nuk trajtohen si koncepte të ekonomisë qarkulluese. Megjithatë, një rast më i fundit që tregon përpjekjet e fushës së akademisë për të sjellë në mjedisin shqiptar konceptin e EQ është Leksioni i Hapur “Ekonomia Qarkulluese: Rasti i Shqipërisë”¹⁷, i organizuar në Qershor 2019 me iniciativën e prof. Fatmir Memaj, profesor në Universitetin e Tiranës.

Gjithashtu, Universiteti Polis dhe Instituti Co-Plan (Instituti për Zhvillimin e Habitaveve) organizoi një Konferencë Rajonale për Ekonominë Qarkulluese në Mars 2020, duke sjellë së bashku akademinë dhe shoqërinë civile të interesuar në diskutimin e kësaj teme të rëndësishme.

Sipas Co-plan dhe Env.Net (2018), Universiteti Polis ka ndërmarrë një qasje aktive ekologjike, që pasqyrohet dhe në ambjentet e tija fizike (nëpërmjet masave eficiente ndaj energjisë), por edhe në kurrikulën e këtij Universiteti, duke qenë se stafi akademik dhe studentët janë shumë aktivë në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit.

Konkluzion

Ky dokument synoi të paraqiste një analizë të legjislacionit dhe iniciativave mbi Ekonominë qarkulluese në Shqipëri. Në këtë kontekst, Informacioni lidhur me ekonominë qarkulluese në Shqipëri paraqet vështirësi për t’u gjetur dhe është shumë i fragmentuar.

Koncepti I ekonomisë qarkulluese në Shqipëri njihet dhe trajtohet shumë pak, sidomos në aspektin ligjor, edhe në atë akademik. Ndërkohë biznesi dhe organizatat e shoqërisë civile janë më aktive në këtë fushë.

¹⁵ <http://www.co-plan.org/en/2647-2/>

¹⁶ <https://www.eden-al.org/index.php/al/lajme/654-ëorkshop-per-ekonomine-qarkulluese>

¹⁷ <https://www.monitor.al/drejt-nje-ekonomie-qarkulluese-por-me-mbeshtetje-sporadike-2/>

Referencat

Boulding, K.E., (1966). “The economics of the coming spaceship earth”.

Commission Staff Working Document: Albania 2018 Report.

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions Closing the loop – An EU action plan for the Circular Economy, COM/2015/0614.

Co-plan, EnvNet., (2018). “Circular Economy Country Specific Report – Written Contribution for the 2018 Annual Report, Albania”.

Ellen MacArthur Foundation (2013) “Towards the Circular Economy Vol. 2: opportunities for the consumer goods sector” - First published January 25, 2013

INSTAT (2016). “Material Flow Accounts”-

<http://www.instat.gov.al/en/themes/environment-and-energy/environmental-accounts/publication/2018/material-flow-accounts-2016/>

National Strategy for Development and Integration (NSDI) 2015 – 2020 National Energy Strategy 2018 – 2030

OECD. EC. ETF. EBRD. (2019). “SME Policy Index Ęstern Balkans and Turkey 2019 – Assessing the implementation of the Small Business Act for Europe”.

Pearce & Turner. (1990). Economics of natural resources and the environment / D.W. Pearce, R.K. Turner” published on February 1990 on American Journal of Agricultural Economics 73.

UNECE. (2016). “Albania Environmental Performance Reviews – third review”. www.turizmi.gov.al